

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA
KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEÇE KAI**

GSK-KPA-A- 186/2013

Prishtinë,
4 gusht 2014

Në çështjen juridike të:

M. V.

Beograd
Serbia

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

Kadri Ahmetaj,
F. Salagrazhde
Suhareke

Pala përgjegjëse në kërkesë/pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nurerdini, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Dag Brathole, anëtarë , duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lënda Je regjistruar në AKP me numrat(KPA20057 dhe KPA20058), i datës 14 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 8 Gusht 2014, morri këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga M. V. i datës 12 qershor 2013, të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-186/13 dhe GSK-KPA-A-187/13 janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-186/13
2. Refuzohen si të pabazuara ankesat e M. V. e paraqitura kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat (KPA20057 dhe KPA20058), i datës 14 dhjetor 2012.
3. Vërtetohet vendimi i të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/180/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrat(KPA20057 dhe KPA20058), i datës 14 dhjetor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 21 nëntor 2006 M. V. në Agjencinë Kosovare të Pronës në Prishtinë ,ka paraqitur dy kërkesa për njohjen e drejtës së pronës private duke pretenduar se është titullar i së drejtës së pronës të paluajtshmërive që janë objekt i kërkesës, me kërkesë për riposedimin e këtyre paluajtshmërive. Kërkesat e paraqitësit të kërkesave janë të regjistruara në Agjencinë Kosovare të Pronës KPA 20058 që i referohen ngastrës kadastrale 114 dhe 115 dhe KPA 20057 që i referohen ngastrës kadastrale 232.
2. Me këto kërkesa ai pretendon se të drejtat pronësore në ato paluajtshmëri nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave drejtpërdrejtë të ndërlydhura ose që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999.
3. Sipas certifikatave mbi të drejtën e pronës së paluajtshme P-72116039-00114 i datës 13.prill.2011, P.nr.72116039-00115 i datës 13.prill.2011 dhe P-72116039-00323 i datës 13.prill.2011 konstatohet se në cilësinë e titullarit të drejtës pronësore që janë objekt i kërkesave të këtyre ngastrave kadastrale me përkufizime dhe përmasa të sakta gjeometrike janë si më poshtë:

Numri i lëndës në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe numri i lëndës së AKP-ës	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-	Ngastra kadastrale nr.115 në vendin e quajtur” Dubravë,” z.k.

186/13 (KPA20058)	Sallagrazhdë, Komuna e Suharekës, në sipërfaqe prej 5.374 m2, e regjistruar në emër të Gjokë dhe Palok Tunajt, në cilësinë e bashkëpronarit
GSK-KPA-186/13 (KPA20058)	Ngastra kadastrale nr. 114 në vendin e quajtur “Dubrova/0ra gat”, z.k. Sallagrazhdë, Komuna e Suharekës, në sipërfaqe prej 5.284 m2, e regjistruar në emër të Martin Tunajt.
GSK-KPA-187/13 (KPA20057)	Ngastra kadastrale nr.323 në vendin e quajtur “Fshat”, z.k. Sallagrazhdë, Komuna e Suharekës, në sipërfaqe prej 1.636 m2, e regjistruar në emër të Osman Ahmetajt

4. Këto certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme „Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së i ka siguruar sipas detyrës zyrtare dhe verifikimi është pozitiv
5. Për t’i mbështetur kërkesat e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet-provat e mëposhtme si:
 - Letërnjoftimin nr. 84365 të lëshuar më datë 10 shtator 1990 nga organet kompetente të Komunës së Prizrenit,
 - Një listë të kollonistit të datës 8 qershor 1933
 - Pesë padi drejtuar Gjykatës Komunale në Suharekë të datës 19.6.1997
6. Aktvendimin e Gjykatës Popullore të Qarkut nr.-164/46-3, aktgjykimin e Gjykatës së Rrethit në Suharekë nr. 362/46-3 i datës 24 dhjetor 1946 , aktgjykimin e Gjykatës së Rrethit në Suharekë C-47/52 të datës 14 gusht 1952.
7. Këto vendime sipas raportit të verifikimit të Agjencisë Kosovare të Pronës nuk janë vlerësuar pozitivisht.
8. Në vitin 2007 dhe 2010 , Ekipi i notifikimit dhe publikimit ka dalë në vend ku supozoheshin që gjendeshin pronat e kërkuara dhe janë vendosur lajmërimi përkatëse në ngastrës kadastrale.
9. Pala përgjegjëse duke paraqitur provat përkatëse në AKP ka pretenduar drejtën e pronës në këto paluajtshmëri. Ata theksojnë se paraqitësi i kërkesës nuk është pronari i këtyre pronave të paluajtshme dhe se në vitin 1952 babai i tij i ka shitur këto prona pasardhësve të tyre.
10. Komisioni për kërkesa pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin grupor KPCC/D/A/180/2012 i datës 14 dhjetor 2012 i ka hedhur kërkesat e palëve si të palejueshme.
11. Në arsyetimin e këtij vendimi që i referohen kërkesave të regjistruara në KPA 20057 dhe KPA 20058 që është e ndërlidhur me ngastrat kadastrale 114,115 dhe 323, theksohet se humbja e posedimit të këtyre ngastrave kadastrale nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur dhe se as që është humbur posedimi i pronave si pasojë e konfliktit. Po ashtu, në arsyetimin e këtij vendimi

theksohet se ato ngastra janë shitur në vitin 1950 dhe nga ajo datë ata nuk kanë qenë në posedim të këtyre paluajtshmërive.

12. Kjo për më tepër se edhe vet paraqitesi i kerkese dhe gruaja e tij kanë pranuar këto fakte relevante. Prandaj, në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin L-03-079 (në tekstin e mëtejshëm Ligji) janë hedhur ato kërkesa për shkak të mungesës së juridiksionit .
13. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (tani e tutje duke ju referuar si: ankuesi) me 24.maj.2013 ndërkaq, i njëjti ka paraqitur ankesë më 13 qershor 2013. Pala përgjegjëse në kërkesë-ankesë (tani e tutje duke ju referuar si: pala përgjegjëse në ankesë) ka pranuar vendimin me 3 maj 2013 dhe se ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palëve

14. Pala ankuese vendimin ankimor e kundërshton për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe gabimeve procedurale të përfshira në këtë vendim. Në ankesën e tij ai pretendon se ,sipërfaqja e tokës së uzurpuar është 08.01.36 ha. Ky uzurpim ka ndodhur në vitin 1941.Më pastaj e njëjta është eksproprijuar dhe përfundimisht është zaptuar më 1999. Vendimi ankimor është i paqartë dhe i përgjithësuar dhe se eksproprijimi mund të zgjidhet me miratimin e Ligjit për restituim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Arsyetimi ligjor

Bashkimi i ankesave:

15. Gjykata Supreme i ka bashkuar ankesat
16. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrija, kur për bashkimin apo shkrijen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrijen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
17. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin

Nr. 03/L-079, Me nenin neni 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

18. Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se, përveç numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 2 (dy) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.
19. Ankesat e paraqitura nga M. V. , të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-186 dhe 187 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numër GSK-KPA-A-187.

Pranueshmëria e ankesave:

20. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.
21. Në rastin konkret vendimet e KKPK-ës i janë dorëzuar ankuesit me datë 24 maj 2013, ndërsa ankesat nga ana e tij janë parashtruar me datë 13 qershor 2013, e që është më pak se 30 ditë nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimet e KKPK-ës.
22. Pala përgjegjëse në ankesë, vendimin ankimor e ka pranuar me datë 3 maj 2013 ankesën e ka pranuar me 10 tetor 2013 por ai nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.
23. Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor,por të njejtat janë të pabazuara.

Meritat:

24. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, në bazë të dokumentacionit të siguruar nga ankuesi, pretendimeve të theksuara në ankesë, provave të siguruar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe ankesa rezulton se vendimi ankimor është marr me vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural, kur ka vendosur në vendimin ankimor që kërkesat e regjistruara në AKP nr. 20057 dhe 20058, duhet të hedhen poshtë si të palejueshme për shkak se ai ka dështuar të paraqet fakte juridikisht të vlefshme dhe të tregojë prova a valide se jo vetëm që është pronar i atyre prona të paluajtshme që është objekt i kërkesës

por edhe që humbja e tyre ka ndodhur për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur.

25. Po kështu Gjykata Supreme konkludon se ankuesi nuk i ka vërtetuar me prova juridikisht të vlefshme faktet relevante se nuk mund të ushtrojë të drejtat pronësore për pronat e kërkuara dhe se ai pikërisht është vendosur nga ato prona dhe se po kështu e ka humbur posedimin apo kontrollin për këto prona si pasojë e konfliktit.
26. Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet ankimore të ankuesit se sipërfaqja e tokës së uzurpuar është 08.01.36 ha se uzurpimi ka ndodhur në vitin 1941, se këto paluajtshmëri janë ekspropriuar dhe së fundi se ato janë uzurpuar në vitin 1999, por gjeti se këto pretendime janë në kundërshtim me provat e administruara dhe faktet e vërtetuara, sikundër në procedurën e komisionit, ashtu edhe nga kjo Gjykatë.
27. Kjo pikërisht për arsye se mbi bazën e certifikatave mbi të drejtën e pronës së paluajtshme që i referohet kërkesës KPA 20057 e që është ndërlidhur me ngastrën kadastrale 323 është e regjistruar në emër të O. A.. Po kështu, edhe ngastrat kadastrale 214 dhe 215 që janë objekt i kërkesës së paraqitësit të kërkesës, e që referohen kërkesës të regjistruar në KPA 20058 sipas certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme janë të regjistruar në emër të M.T.dhe Gj.e P. T.
28. Përpos kësaj sikundër ankuesi ashtu edhe bashkëshortja e tij më datë 3 tetor 2012, kanë konfirmuar se humbja e posedimit të ngastrave të kërkuara nuk është pasojë e konfliktit. Ajo më tej ka theksuar se ngastrat kadastrale 214 dhe 215 që i referohen kërkesës KPA 20058 se, janë shitur në vitin 1952. Ndërkaq, ngastra 323 që i referohen kërkesës 20057 është shitur në vitin 1954 dhe se prej asaj kohe nuk kanë qenë në posedim.
29. Paditë e paraqitura në Gjykatën Komunale Suharekë më datën 19.6.1997, si dhe disa aktgjykime në fotokopje të Gjykatës së Rrethit në Suharekë të viteve 1950 ,nuk korrespondojnë me ngastrat që janë objekt i kërkesës, ndaj edhe janë edhe i relevante në këtë çështje juridike kontestimore.
30. Rrjedhimisht më të sipërmen mbi bazën e provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara pa mëdyshje mund të konkludohet se drejt është zbatuar dispozita e nenit 3.1 të Ligjit kur është hedhë kërkesa e paraqitësit të tyre në mungesë të juridiksionit. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se Gjykata Supreme ka juridiksion në rastet kur të drejtat pronësore nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që lidhen direkt ose që janë rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur mbrenda periudhës kohore midis 27 shkurt dhe qershor 1999. Në rastin konkret, objekt shqyrtimi i kërkesës së paraqitur i referohet eventualisht kontesteve jashtë periudhës së parashikuar me këtë dispozitë ligjore dhe se nuk ka të bëjë asgjë më këtë konflikt.
31. Duke qenë se, sipas certifikatave mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nga paragrafi 3 i të arsyetimit të këtij, aktgjykimi konstatohet se, ngastra që janë objekt i kërkesës nuk janë të

regjistruara në emër të ankuesit ndaj, sipas dispozitës së nenit 7 par 2 të Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, supozohet se këto të dhëna janë të sakta, të vërteta, dhe të ligjshme derisa të mos korrigjohen në bazë të procedurave të themeluara me ligj. Prandaj, nëse eventualisht pala ankuese pretendon se regjistri i të drejtës mbi këtë pronë të paluajtshme në Zyrë Kadastrale Gjilan nuk është i ligjshëm dhe se cenon të drejtat e tij, atëherë ka autorizime dhe përgjegjësi që sipas dispozitës së nenit 5.4 të së njëjtit Ligj të iniciojë procedurë përkatëse gjyqësore për t'i vërtetuar ato pretendime.

32. Nga sa u paraqit më lartë me zbatim të dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u refuzua ankesa si e pabazuar duke u vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Gjyqtar Kryesues

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it